# DËSHMI ARKIVI

**A-477139**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E rëndë në Brazil, nënë e bijë vdesin nga kanceri me vetëm 10 orë diferencë, familja: Është e trishtueshme, e vështirë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/28/e-rende-ne-brazil-nene-e-bije-vdesin-nga-kanceri-me-vetem-10-ore-diference-familja-eshte-e-trishtueshme-e-veshtire/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 17:16:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 17:12:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 17:11:00 UTC → 28 shtator 2026, 17:13:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `847fa788f1f06affabcda2a21b07fe005f809f979d7976a5d2a04cc60b58e66b` |
| TEKSTI | `4881dd79caa313403f8c7a10d7e53e8a8236f284bfb23bbde93cec265bfcae27` |
| PAMJA | `ffdf9638a935231a0fc10ddf89490fd6b6a35a9587da49b89b5d2ea7ec3357f3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b77c10341c3f3c2cd5a15fde1b5a4db52c8850c861af00980eded3c31980b9bb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b77c10341c3f3c2cd5a15fde1b5a4db52c8850c861af00980eded3c31980b9bb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | TË FUNDIT

# E rëndë në Brazil, nënë e bijë vdesin nga kanceri me vetëm 10 orë diferencë, familja: Është e trishtueshme, e vështirë

28/09/2026 19:12



**Një familje në Brazil është përballur me një tragjedi të rëndë, pasi një nënë dhe vajza e saj 28-vjeçare humbën jetën nga kanceri me vetëm 10 orë diferencë.**

Cibele Marchis, 28 vjeçe, ndërroi jetë të enjten rreth orës 16:00 në një spital në Mogi Guaçu. Vetëm 10 orë më vonë, rreth orës 02:00 të së premtes, ndërroi jetë edhe nëna e saj, Maria Elisabete Nogueira, 56 vjeçe, e cila ndodhej e shtruar në një tjetër spital të qytetit.

Cibele, e cila punonte si specialiste e marketingut dixhital, ishte diagnostikuar në vitin 2024 me një formë të rrallë dhe agresive të kancerit që kishte nisur në gjëndrën mbiveshkore.

Rreth një vit më vonë, Maria mësoi se vuante nga kanceri i pankreasit. Ajo kishte shkuar te mjeku për një problem që besonte se lidhej me gurët në tëmth, por analizat zbuluan sëmundjen e rëndë.

Cibele iu nënshtrua disa ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimeve me kimioterapi. Në dhjetor të vitit 2025, familja u njoftua se ajo ishte pranë fundit të jetës pasi kishte pësuar infeksione të rënda.

E afërmja e tyre, Barbara Rodrigues dos Santos, tregoi se në ato momente nënë e bijë ishin mbështetja e njëra-tjetrës.

Sipas saj, Maria kishte agjëruar për 24 orë duke u lutur për një mrekulli për vajzën e saj. Cibele arriti të përmirësohej, doli nga spitali dhe u rikthye në jetën e saj.

*"Dëshironte të jetonte"*, tregoi Barbara, duke shtuar se Cibele nuk e kishte lejuar sëmundjen, shenjat e operacioneve apo qesen e kolostomisë t'a pengonin të jetonte jetën.

Ndërkohë, gjendja e Marias ishte përkeqësuar me shpejtësi. Dhimbjet ishin bërë aq të forta sa ajo kishte nevojë për morfinë dhe më 17 shtator u shtrua në spital.

Nëna dhe vajza u takuan për herë të fundit kur Cibele vizitoi Marian gjatë qëndrimit të saj në spital. Rreth një javë më vonë, gjendja e Cibeles u përkeqësua dhe ajo kishte nevojë për trajtim mjekësor.

*"Kur mora telefonatën të enjten, të gjithë prisnin që të ishte halla ime, jo Cibele"*, rrëfeu Rowilson Leandro da Costa, nipi i Marias dhe kushëriri i Cibeles.

Ai tregoi se ishte marrë me organizimin e ceremonisë mortore të Cibeles dhe, pasi familja u kthye nga ceremonia, mori telefonatën për vdekjen e Marias.

*"Duhej t'i jepja sërish lajmin xhaxhait tim, i cili po vajtonte vajzën e tij, se kishte ndërruar jetë edhe gruaja e tij"*, tregoi ai.


## Kryesore



VIDEO/ Përfshihet nga flakët makina në Elbasan, qytetarët vrapojnë të panikosur: Dëgjuam shpërthim
18:37

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë
12:58

"Shtatë kandidatë për BE, sa fëmijët e Ursulës"/ Ironia e Ramës: Von der Leyen nuk u tha vajzave "shko me gangsterin rus" apo "luaj me lodrat kineze"
11:06

Puna e bërë duhet t'i njihet Shqipërisë"/ Zyrtari i lartë i BE, McAllister: Parlamenti Europian do vijojë mbështetjen
12:22

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni
10:15

## Më të lexuarat

"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF

Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale të mos cenojnë besimin te shteti

FOTOLAJM/ U shfaq për herë të parë në publik, kush është Elvis Lila, drejtuesi i SHISH i komanduar nga Rama

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, 160 milionë të humbura, jeta e shfrenuar e Roberto Carlos

Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

"Ne këtu gjejmë arsye shpesh për debat, por biem dakord vetëm për...", Rama mesazhe të

Cibele ishte fëmija i vetëm i çiftit. Pas humbjes së vajzës dhe bashkëshortes, babai i saj ka mbetur i vetëm.

*"E humbi familjen. Të kthehet në shtëpi dhe të mos gjejë më askënd aty. Është e trishtueshme, e vështirë"*, tha Rowilson.

Një tjetër detaj prekës i historisë është se nëna dhe vajza kishin shprehur dëshirën që asnjëra të mos mësonte për vdekjen e tjetrës, nëse njëra prej tyre do të ishte ende gjallë.

*"Asnjëra nuk donte t'a shihte tjetrën të vdiste. E kishin komentuar këtë, herë me shaka dhe herë seriozisht, dhe pikërisht kështu ndodhi. Njëra nuk e mori vesh kurrë për vdekjen e tjetrës"*, tha Rowilson.

Cibele kishte ndarë publikisht edhe momente nga përballja me sëmundjen. Në mars, ajo publikoi një video gjatë një trajtimi me serum, duke shkruar se për sa kohë problemi i vetëm i një personi është paraja, duhet të jetë mirënjohës, pasi ka probleme që as gjithë paratë e botës nuk mund t'i zgjidhin.

Partnerja e saj e biznesit, Eloa Righi, tha se Cibele nuk lejoi që kanceri të përcaktonte identitetin e saj.

*"Ajo nuk donte të njihej si Cibele që ka kancer, por si Cibele që punon, argëtohet, jeton dhe ka kancer"*, u shpreh ajo.

Edhe Maria, e njohur nga të afërmit me nofkën Bia, përshkruhet si një grua e dashur dhe e gëzuar, e cila kishte lënë gjurmë te njerëzit që e njihnin.

Nënë e bijë u përcollën së bashku për në banesën e fundit, në një ceremoni të përbashkët mortore, të rrethuara nga familjarët dhe miqtë e tyre.

**Top Channel**

qarta BE-së: Nëse lini Shqipërinë në baltë, do jetë dështimi juaj më i madh

Shkarkimi i Vlora Hysenit, mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare i thirrur nga Presidenti Begaj

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

## Bota »



**Apple gjobitet me 5.7 miliardë dollarë, përdori pa leje teknologjinë e një kompanie tjetër**

28/09 19:00



**Komandanti i NATO-s: Rusia po rrit presionin mbi qeveritë evropiane për të ndalur mbështetjen ndaj Kievit**

28/09 18:41



**Tragjedi në Angli/ Nëna dhe 3 fëmijët humbin jetën nga zjarri në shtëpi, familjarët: Jemi zemërthyer**

28/09 18:28



**VIDEO/ "Unë jam përgjegjës për ferrin tënd", ministri izraelit i Sigurisë Kombëtare kërcënon të burgosurin palestinez: Fundi yt është...**

28/09 17:19



**Në prani të Papës, Macron i kërkon Europës t'i rezistojë nacionalizmit dhe urrejtjes**

28/09 16:46



**SpaceX teston Starship në fluturimin e 14-të, synimi historik të hyjë për herë të parë në orbitë**

28/09 16:45

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »








Top News- Sirenat e zjarrfikëses kumbojnë në Elbasan, “shpërthen” në flakë makina

Top Channel/ Makina shkrumbohet plotësisht në qendër të Elbasanit, qytetarët në panik

Top Channel/ Zjarri në Kreshpan, banori: Në kohën e Enverit bëheshin kavaleta kashte, pse tani…

Top Channel/ Vijon zjarri në Kreshpan, shoqërohen 3 persona të dyshuar për zjarrvënie

Top News- Shqipëria prezantohet me 17 startup-e në Bits & Pretzels 2026 në Mynih

Top Channel/ “Jam përgjegjës për ferrin tënd”, ministri izraelit i kërcënon të burgosurin palestinez




**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.